



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.45

2005

14 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9397 datë 12.5.2005	Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve..	1609
Ligj nr.9398 datë 12.5.2005	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000	1614
Ligj nr.9399 datë 12.5.2005	Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare.....	1617
Ligj nr.9400 datë 12.5.2005	Për një ndryshim në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Kombëtar", i ndryshuar.....	1621
Ligj nr.9407 datë 19.5.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".....	1622
Ligj nr.9408 datë 19.5.2005	Për disa ndryshime në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar.....	1624
Ligj nr.9414 datë 20.5.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 "Për shkollën e magistraturës të Republikës së Shqipërisë".....	1627
Ligj nr.9415 datë 20.5.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8032, datë 16.11.1995 "Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve të tij", i ndryshuar.....	1634

Ligj nr.9416 datë 20.5.2005	Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave.....	1635
Ligj nr.9417 datë 20.5.2005	Për disa shtesa në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar	1641

LIGJ
Nr.9397, datë 12.5.2005

PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË SISTEMIN E BURGJEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton organizimin, funksionimin, detyrat dhe fushën e veprimtarisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve (SHKBB).

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së SHKBB-së

Fusha e veprimtarisë së këtij Shërbimi është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprimtarisë kriminale, të kryer nga punonjës të Policisë së Burgjeve, nga struktura të tjera të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për çështje që lidhen me sigurinë në burgje.

Neni 3
Parimet bazë të veprimtarisë së SHKBB-së

Parimet bazë të ushtrimit të veprimtarisë së SHKBB-së janë ligjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, sekreti dhe pavarësia nga ndërhyrjet e parregullta në kryerjen e detyrës.

Neni 4
Autoriteti përgjegjës për veprimtarinë e SHKBB-së

1. Ministri i Drejtësisë ose personi i autorizuar prej tij është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë dhe për ushtrimin normal të veprimtarisë së SHKBB-së.

2. Për të siguruar zbatimin e ligjit në veprimtarinë informative dhe gjurmuese, si dhe në fillimin e kryerjen e veprimeve procedurale të hetimit paraprak informohen organet e prokurorisë dhe për çështje të veçanta edhe Prokurori i Përgjithshëm.

KREU II
ORGANIZIMI I SHKBB-SË

Neni 5
Krijimi i SHKBB-së

1. Në Ministrinë e Drejtësisë krijohet Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

2. SHKBB-ja është strukturë e veçantë në sistemin e Policisë së Burgjeve, me natyrë informativo-gjurmuese dhe organizim unik e të centralizuar, që drejtohet nga Drejtori i këtij Shërbimi.

3. SHKBB-ja e ushtron veprimtarinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në

strukturat në varësi të saj.

Neni 6

Buxheti i SHKBB-së dhe mënyra e përdorimit

1. Në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, në pjesën për sistemin e burgjeve, miratohet një fond i veçantë buxhetor për ushtrimin e veprimtarisë informative të SHKBB-së dhe për shpërblimin e personave, që bashkëpunojnë me të.

2. Kriteret dhe mënyra e administrimit, përdorimit dhe kontrollit të këtyre fondeve të veprimtarisë informative dhe operative të SHKBB-së caktohen nga Ministri i Drejtësisë, pasi të jetë marrë mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Financave, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Struktura dhe organika e SHKBB-së

1. Struktura dhe numri i përgjithshëm i punonjësve të SHKBB-së janë pjesë përbërëse e strukturës dhe e numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Struktura dhe organika e SHKBB-së, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, miratohen nga Kryeministri.

KREU III

EMËRIMI DHE LARGIMI NGA DETYRA I PUNONJËSVE TË SHKBB-SË

Neni 8

Kërkesat e përgjithshme të pranimit në SHKBB

Për t'u pranuar në SHKBB mund të kandidojë shtetasi shqiptar që përmbush kërkesat e përgjithshme, si më poshtë:

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- b) ka arsimin përkatës;
- c) nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;
- ç) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose nga shërbimi civil, për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- d) ndaj tij nuk është marrë masë tjetër disiplinore ose administrative, që nuk është shlyer dhe, në çdo rast, së paku deri në tre vjet përpara datës së paraqitjes së kërkesës për pranim.

Neni 9

Parime të konkurrencës dhe të përzgjedhjes së kandidatëve

1. Pranimi në SHKBB kryhet nëpërmjet konkurrencës të hapur, mbështetur në parimet e profesionalizmit, të aftësive të veçanta, cilësive të larta morale, ndershmërisë dhe përkushtimit ndaj detyrës.

2. Kandidatët për t'u pranuar në SHKBB përzgjidhen, si rregull, ndërmjet punonjësve në detyrë në sistemin e Policisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit, në struktura të tjera policore ose të atyre që kanë përvojë në ushtrimin e detyrave profesionale në shërbimet informative.

3. Sipas përshkrimit të veçantë të vendit vakant të punës, në kriteret e konkurrencës parashikohen edhe kriteret e posaçme preferenciale për llojin e arsimit të lartë, policor ose civil, përvojën dhe kualifikimet e nevojshme në shërbime informative dhe në detyra të tjera, që kanë të bëjnë me verifikimin, gjurmimin, zbulimin dhe hetimin paraprak penal të shkeljeve të ligjit.

4. Mënyra e organizimit dhe kushtet e posaçme të konkurrencës, kriteret e vlerësimit dhe përbërja e komisioneve caktohen nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 10

Emërimi, lirimi dhe largimi nga detyra

1. Emërimi, lirimi dhe largimi nga detyra i Drejtorit të SHKBB-së bëhet nga Ministri i Drejtësisë.

2. Emërimi, lirimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të SHKBB-së bëhet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të SHKBB-së.

Neni 11

Rastet e lirimit dhe të largimit nga detyra

1. Punonjësi i SHKBB-së lirohet nga detyra në rastet kur:

a) ka mbushur moshën për pension;

b) bëhet i paafte nga ana shëndetësore, për një periudhë kohe mbi 6 muaj, me ose pa vendim të komisionit mjekësor;

c) me kërkesën e vet, pasi ka plotësuar detyrimet sipas dispozitave në fuqi;

ç) për shkak të ristrukturimit dhe shkurtimit të funksionit organik.

2. Në rastet kur punonjësi lirohet nga detyra, sipas shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, kur ai merr riaftësimin shëndetësor, ose kur krijohen vende dhe funksione të reja, ai gëzon të drejtën e kërkesës dhe të përzgjedhjes me përparësi për t’u punësuar, në mbështetje të formimit, kualifikimit dhe vjetërsisë që kishte në këtë shërbim përpara lirimit nga detyra.

3. Punonjësi i SHKBB-së largohet nga detyra në rastet kur:

a) shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat e disiplinës dhe të shërbimit dhe masa e dhënë më parë nuk është shlyer;

b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 12

Rregulla për marrëdhëniet e punës dhe disiplinën në SHKBB

1. Rregullat e hollësishme për marrëdhëniet e punës dhe disiplinën në SHKBB, kompetencat, rastet, procedurat dhe llojet e masave disiplinore caktohen në Rregulloren e Disiplinës së SHKBB-së.

2. Rregullorja e Disiplinës së SHKBB-së miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të SHKBB-së.

Neni 13

Sistemimi në detyrë pas lirimit nga SHKBB-ja

Punonjësi i SHKBB-së, kur lirohet nga detyra ose në përfundim të periudhës së caktuar për të punuar në këtë Shërbim, emërohet në detyrë tjetër, pranë strukturave policore ose të administratës publike, që përputhen ose janë të përafërta me aftësitë dhe përvojën e tij profesionale.

KREU IV

VEPRIMTARIA E SHKBB-SË

Neni 14

Metoda e punës dhe garancitë në veprimtarinë e SHKBB-së

1. SHKBB-ja e ushtron veprimtarinë informativo-gjurmuese dhe të hetimit paraprak, duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut, normat e Kodit të Procedurës Penale, ato për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, si dhe dispozitat e këtij ligji.

2. SHKBB-ja e ushtron veprimtarinë duke përdorur forma, metoda e mjete pune informative, të hapura e të mbyllura, të mbështetura në ligj, sipas standardeve që zbatohen nga Shërbimi Informativ i Shtetit. Këto procedura miratohen nga Ministri i Drejtësisë dhe nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka të drejtë të ushtrojë kontrolle për mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 15

Ushtrimi i attributeve të Policisë Gjyqësore në SHKBB

1. Punonjësit e SHKBB-së ushtrojnë atributet e Policisë Gjyqësore.
2. Në strukturën e SHKBB-së funksionojnë edhe shërbime të Policisë Gjyqësore, sipas ligjit nr.8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Neni 16

Detyrime të ndërsjella të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe SHKBB-së

1. Drejtuesit dhe punonjësit e sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë të detyruar të bashkëpunojnë me SHKBB-në në ushtrimin e detyrave për zbatimin e këtij ligji.
2. Ata informojnë Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve në mënyrë të vazhdueshme për veprimtarinë kriminale që cenon sigurinë në burgje.
3. Kur ka informacione, që nuk përbëjnë vepër penale, ky Shërbim informon sipas përkatësisë së shkeljeve të konstatuara.

Neni 17

Të drejtat e SHKBB-së

SHKBB-ja ka të drejtë:

- a) të mbledhë, të administrojë, të ruajë, të verifikojë dhe të dokumentojë të dhëna për veprimtari kriminale, kur ato kryhen nga punonjësit e strukturave në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pavarësisht nga detyra dhe gradat e tyre;
- b) të kërkojë dhe të shfrytëzojë dokumentacionin e arkivuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në strukturat në varësi të saj;
- c) të mbledhë, të administrojë dhe të përpunojë informacione, të dhëna vullnetarisht nga punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve, nga persona të paraburgosur ose të dënuar, si dhe nga subjekte e persona të tjerë.

Neni 18

Bashkëpunimi me shërbime të tjera informative

SHKBB-ja, për realizimin e misionit të saj, bashkëpunon, shkëmben informacione e ndërton plane të përbashkëta veprimtarie me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik, me Shërbimin Informativ Ushtarak, si dhe me shërbime të tjera operative gjurmuese, pasi të ketë marrë miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 19

Detyrimi për kalimin e informacionit të SHKBB-ja

Kur drejtuesit dhe punonjësit e sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kanë dijeni ose marrin dijeni, nëpërmjet institucioneve të tjera shtetërore dhe subjekteve ose individëve të ndryshëm, për informacione të përfshirjes në veprimtari kriminale të punonjësve të këtij sistemi, pavarësisht nga hierarkia administrative e tyre, janë të detyruar të njoftojnë dhe t'i kalojnë menjëherë për dijeni dhe kompetencë SHKBB-së.

Neni 20

Njoftimi i rasteve të arrestit në flagrancë

Kur organet kompetente, sipas ligjit, realizojnë veprime të arrestit në flagrancë të një punonjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ose të strukturave në varësi të saj, janë të detyruara të njoftojnë menjëherë SHKBB-në.

Neni 21

Ruajtja, administrimi dhe përdorimi i informacionit të klasifikuar dhe atij "Sekret shtetëror"

1. Kur informohen nga SHKBB-ja për veprimtari kriminale ose akte të tjera, që cenojnë sigurinë në burgje, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve detyrohen të ruajnë, në çdo rast, karakterin e informacionit të klasifikuar "sekret", burimet e tij dhe format e punës.

2. Drejtuesit dhe punonjësit e Drejtësisë së Përgjithshme të Burgjeve, të strukturave në varësi të saj, që njihen me informacionet e SHKBB-së, vihen në dijeni dhe detyrohen ta ruajnë karakterin sekret të tij.

3. Dokumentacioni dhe informacioni që mbledh, administron e ruan SHKBB-ja është i klasifikuar "Sekret shtetëror" dhe ruhet e administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror".

4. Ministri i Drejtësisë nxjerr rregulla të hollësishme për administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit dhe të informacionit të SHKBB-së, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 22

Ruajtja e sekretit shtetëror pas largimit ose lirim të nga SHKBB-ja

Punonjësi i SHKBB-së detyrohet të ruajë sekretin shtetëror për informacionin që administron ose për të cilin ka pasur dijeni për shkak të detyrës. Detyrimi i ruajtjes së sekretit vazhdon edhe pasi punonjësi i shkëput marrëdhëniet e punës me këtë Shërbim.

Neni 23

Përgjithësimi nga publikimi

Të dhënat, informacionet dhe burimet e krijuara dhe të administruara nga SHKBB-ja përjashtohen nga detyrimet për t'u bërë publike, përveçse kur një gjë e tillë autorizohet paraprakisht me shkrim nga Ministri i Drejtësisë.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Aktet nënligjore të Ministrit të Drejtësisë

Ministri i Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, merr masa dhe nxjerr akte nënligjore për:

- a) çështje të përditshme të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë informative të SHKBB-së;
- b) marrëdhëniet dhe komunikimin e SHKBB-së me struktura të tjera të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
- c) mbrojtjen e burimeve të të dhënave dhe metodave nga ekspozimi i paautorizuar;

ç) çështje të klasifikimit dhe deklasifikimit të të dhënave, që përbëjnë sekret shtetëror në sistemin e informacioneve të SHKBB-së;

d) çështje të grumbullimit, përpunimit dhe administrimit të informacionit, për të cilin vihen në dijeni drejtuesit dhe punonjësit e sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;

dh) shfrytëzimin e sistemit të arkivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga SHKBB-ja;

e) sistemin e pagave dhe trajtimin e punonjësve të SHKBB-së, duke paraqitur në Këshillin e Ministrave propozimet përkatëse;

ë) programet e formimit profesional dhe kualifikimin e punonjësve të SHKBB-së, në mënyrë të detyrueshme, pranë strukturave të Shërbimit Informativ të Shtetit, si dhe në institucione të tjera të veprimit informativ, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4602, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9398, datë 12.5.2005

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8454, DATË 4.2.1999 "PËR AVOKATIN E POPULLIT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8600, DATË 10.4.2000

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 dhe 2 shkronja "a" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Avokati i Popullit kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligje të veçanta.”.

Neni 2

Në fund të nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Para marrjes ose rimarrjes së detyrës, Avokati i Popullit bën betimin para Kuvendit. Formula e betimit është:

"Betohe se gjatë kryerjes së detyrave të mia do të mbroj kurdoherë liritë dhe të drejtat themelore të njerëzve pa dallim, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 3

Në fund të nenit 13 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur ose i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.”.

Neni 4

Në nenin 14, pas fjalës “organeve” shtohen fjalët "të cilat duhet t'u përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë."

Neni 5

Në nenin 19 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “a” shtohen fjalët “përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.”.

2. Në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet.”.

3. Në fund të nenit shtohet fjalia:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.”.

Neni 6

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Avokati i Popullit ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit), në reparte ose në institucione shtetërore, në spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet ose mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.”.

Neni 7

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “b” shtohet fjalia “Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.”.

2. Në fund të shkronjës “c” shtohet fjalia “Mosshqyrtimi i rekomandimit brenda 30 ditëve pezullon aktet ose veprimet e paligjshme ose të parregullta.”.

3. Në fund të shkronjës “ç” shtohen fjalët “ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara.”.

Neni 8

Në fund të nenit 22 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij.”.

Neni 9

Pas nenit 22 shtohet nenin 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit

Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”.

Neni 10

Në nenin 24, shkronjat “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“b) t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktajnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.”.

Neni 11

Në nenin 25 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e dytë hiqen shkronjat “a” dhe “c”.

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.”.

Neni 12

Në fund të nenit 26 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Raporti vjetor për vitin pasardhës duhet të paraqitet jo më vonë se 30 prilli i vitit në vazhdim.”.

Neni 13

Në fund të nenit 34 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Këta mund të shkarkohen edhe me kërkesën e Avokatit të Popullit para mbarimit të afatit 3-vjeçar për shkelje në detyrë apo sjellje dhe akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tyre.”.

Neni 14

Në fund të nenit 35 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Avokati i Popullit dhe tre komisionerët përfitojnë falas Fletoren Zyrtare.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4603, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9399, datë 12.5.2005

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KONFERENCËS GJYQËSORE
KOMBËTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetesh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Konferenca Gjyqësore Kombëtare e Shqipërisë

1. Konferenca Gjyqësore Kombëtare e Shqipërisë (KGJK) është organi përfaqësues i gjyqtarëve të të gjitha niveleve të Republikës së Shqipërisë. KGJK-ja zgjidhet nga Konferencat Gjyqësore Rajonale (KGJR), siç parashikohet në nenin 4 të këtij ligji.

2. KGJK-ja është person juridik.

3. Buxheti i KGJK-së përfshihet në buxhetin e gjykatave dhe administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Neni 2

Kompetencat

KGJK-ja ka këto kompetenca:

a) zgjedh anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), në përputhje me nenin 147 pika 1 të Kushtetutës;

b) mbron pavarësinë e pushtetit gjyqësor, parashikuar nga neni 145 pika 1 i Kushtetutës;

c) përcakton drejtimit kryesorë të veprimtarisë së gjykatave, në përputhje me nenin 135 pika 1 të Kushtetutës;

ç) paraqet propozime e rekomandime tek autoritetet përkatëse shtetërore, sipas rastit, për një administrim të paanshëm dhe efikas të gjykatave të Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 135 pika 1 të Kushtetutës;

d) bën propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional të pushtetit gjyqësor, në përputhje me Kushtetutën.

Neni 3

Funksionimi i KGJK-së

1. KGJK-ja mbledhet të paktën një herë në vit në mbledhje vjetore. Mbledhje të tjera të KGJK-së mund të zhvillohen në çdo kohë. KGJK-ja mund të veprojë edhe me vota të shkruara pa mbledhje, përveç rasteve të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e cila zhvillohet në seancë plenare. Vendimet janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga dy të tretat e anëtarëve të KGJK-së, në rastet kur ajo vepron me vota të shkruara, për të cilat ndiqet një procedurë e veçantë e përcaktuar në

Rregulloren e KGJK-së.

2. Kryetar i KGJK-së është Kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë. Në mungesë të tij, KGJK-ja drejtohet nga Zëvendëskryetari.

3. Mbledhjet e KGJK-së thirren nga Kryetari i Gjykatës së Lartë me nismën e tij ose me kërkesë me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të KGJK-së.

4. Për mbledhjen vjetore të KGJK-së, të gjithë anëtarët e saj njoftohen me shkrim të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen vjetore, sipas nenit 4 të këtij ligji. Për çdo mbledhje tjetër, anëtarët njoftohen me shkrim të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.

Neni 4

Anëtarët e Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe Konferencat Gjyqësore Rajonale

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë, gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Lartë, kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe kryetarët e gjykatave të apelit janë anëtarë të KGJK-së për shkak të detyrës që ata kryejnë. Anëtarët e tjerë të KGJK-së zgjidhen nga Konferencat Gjyqësore Rajonale dhe përbëjnë dyfishin e numrit të anëtarëve, që zgjidhen për shkak të detyrës.

2. KGJR-të ngrihen aty ku ushtron juridiksionin gjykata e apelit përkatës. Secila KGJR përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës së apelit. Gjykatat e tjera të apelit, për efekt të këtij neni, përfshihen në KGJR-në ku ato kanë qendrën.

3. KGJR-të i zhvillojnë mbledhjet e tyre vjetore të paktën 60 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen vjetore të KGJK-së. Mbledhjet e tjera, secila KGJR mund t'i zhvillojë në çdo kohë. Me propozimin e Kryetarit të saj, KGJK-ja përcakton numrin e anëtarëve që do të zgjedhë çdo KGJR.

4. Mbledhjet e KGJR-së thirren nga kryetari i gjykatës së apelit përkatës. Njoftimi i mbledhjes u jepet me shkrim të gjithë gjyqtarëve, që janë anëtarë të KGJR-së përkatëse, të paktën dy javë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.

5. Në mbledhjen vjetore, secila KGJR zgjedh nga radhët e saj anëtarët për në KGJK. Numri i anëtarëve për çdo KGJR caktohet në këtë mënyrë: raporti i numrit të anëtarëve të KGJK-së që zgjidhen nga një KGJR, duke përfshirë edhe anëtarët për shkak të detyrës, me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të KGJK-së, të jetë i njëjtë me raportin e numrit të gjyqtarëve të KGJR-së përkatëse me numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të të gjithë vendit. Në këtë përlllogaritje nuk përfshihen Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë.

6. Mandati 1-vjeçar i anëtarëve të zgjedhur të KGJK-së fillon menjëherë pas zgjedhjes së tyre nga KGJR-ja dhe vazhdon deri në çastin që pasardhësi i tyre të zgjidhet nga KGJR-ja në mbledhjen vjetore të saj të vitit të ardhshëm, ose derisa ata japin dorëheqjen nga KGJK-ja apo nga të qenët gjyqtar, ose kur shkarkohen si gjyqtarë. Nëse një anëtar i zgjedhur i KGJK-së bëhet anëtar për shkak të detyrës, si rezultat i zgjedhjes në Gjykatën e Lartë ose të emërimit si kryetar gjykate, vendi vakant i krijuar plotësohet në mbledhjen e ardhshme të KGJK-së përkatëse.

7. KGJR-ja ka të drejtë t'i sugjerojë KGJK-së propozime të ndryshme në lidhje me drejtimit kryesorë që duhet të zbatohen dhe me administrimin e veprimtarisë së gjyqësorit.

Neni 5

Zgjedhja e anëtarëve për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

1. Në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës, si dhe të dispozitave ligjore në fuqi, KGJK-ja, në mbledhjen e saj plenare, zgjedh anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për çdo vend vakant, KGJR-ja përkatëse propozon dy kandidatura.

2. Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës së Lartë, që janë anëtarë të KLD-së, në asnjë rast nuk marrin pjesë në mbledhjet e KLD-së kur ajo shqyrton e vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve.

3. KGJK-ja i zgjedh anëtarët e KLD-së në një mënyrë të tillë që në përbërjen e KLD-së, në çdo kohë, të mos ketë më shumë se katër gjyqtarë apeli, prej të cilëve një nga KGJR-ja e Tiranës dhe një nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Gjithashtu, nga një gjykatë e shkallës së parë nuk mund të zgjidhet më shumë se një anëtar i KLD-së, me përjashtim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nga e cila nuk mund të zgjidhen më shumë se dy anëtarë.

4. Gjyqtarët që rezultojnë të ndëshkuar me masa disiplinore, për aq kohë sa këto masa janë në fuqi, ndalohej të zgjidhen nga KGJK-ja anëtarë të KLD-së.

Neni 6

Këshilli Ekzekutiv

1. Këshilli Ekzekutiv i KGJK-së përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe katër nga kryetarët e gjykatëve të apelit, duke përfshirë gjykatat e tjera të apelit, si dhe dhjetë kryetarë të gjykatave të shkallës së parë. Këta të fundit zgjidhen nga KGJK-ja në mbledhjen vjetore dhe kryejnë një mandat 1-vjeçar pa të drejtën e rizgjedhjes së njëpasnjëshme. Në qoftë se gjykatat e apelit, që përfshihen në KGJR-në përkatëse, nuk rezultojnë të përfaqësuara në Këshillin Ekzekutiv, atëherë në masën që është e mundur duhet të sigurohet përfaqësimi në Këshillin Ekzekutiv prej gjykatave të shkallës së parë.

2. Këshilli Ekzekutiv vepron në emër të KGJK-së ndërmjet mbledhjeve të saj. Kryetari i Gjykatës së Lartë kryeson Këshillin Ekzekutiv dhe në mungesë të tij, Zëvendëskryetari. Zëvendëskryetari zgjidhet prej Këshillit Ekzekutiv nga radhët e tij.

3. Këshilli Ekzekutiv mblidhet kur thirret nga Kryetari ose Zëvendëskryetari. Njoftimi i mbledhjes u jepet me shkrim të gjithë anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të paktën një javë përpara datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes. Këshilli Ekzekutiv mund të marrë vendime me shkrim mbi bazën e votave të shkruara pa mbledhje, kur ato janë të firmosura nga Kryetari dhe nga shumica e të gjithë anëtarëve të tjerë.

4. Këshilli Ekzekutiv vendos detyrat dhe kompetencat e komisioneve të KGJK-së.

5. Këshilli Ekzekutiv cakton rendin e ditës për mbledhjet vjetore dhe mbledhjet e tjera të KGJK-së dhe raporton përpara çdo mbledhjeje për veprimtarinë e tij që nga mbledhja e fundit e KGJK-së. Propozimet e bëra nga KGJR-të merren parasysh nga Këshilli Ekzekutiv në caktimin e rendit të ditës, si dhe në referimin e çështjeve te komisionet.

6. Këshilli Ekzekutiv është përgjegjës për mbikëqyrjen e organizimit dhe administrimit të brendshëm të KGJK-së.

7. Këshilli Ekzekutiv harton projektin e Rregullores, të cilën e miraton KGJK-ja.

Neni 7

Buxheti

Me buxhetin gjyqësor veprohet si më poshtë:

a) Këshilli Ekzekutiv dhe komisioni i buxhetit të KGJK-së, të parashikuar në nenin 9 pika 3 shkronja "a", shqyrtojnë dhe miratojnë çdo vit kërkesat e gjyqtarëve për buxhetin para se Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ), që është krijuar dhe vepron sipas ligjit nr. 8363, datë 1.7.1998 "Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor", t'ia dërgojë projektbuxhetin Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

b) Kryetari i KGJK-së, anëtarët e tjerë të Këshillit Ekzekutiv, si dhe anëtarët e komisionit të buxhetit të KGJK-së, të asistuar nga ZABGJ-ja, i prezantojnë dhe mbrojnë para Kuvendit kërkesat e gjyqësorit për buxhetin.

Neni 8

Mbështetja administrative, teknike dhe shkencore e KGJK-së

1. Shërbimet e nevojshme administrative dhe teknike për funksionimin e KGJK-së kryhen nga stafi përkatës i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

2. KGJK-ja bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe siguron prej saj mbështetjen e nevojshme shkencore.

Neni 9

Komisionet e KGJK-së

1. Komisionet e KGJK-së kanë për detyrë të këshillojnë dhe t'u bëjnë rekomandime KGJK-së dhe Këshillit Ekzekutiv në lidhje me politikat dhe programet, sipas fushave të tyre të kompetencës. Ata dorëzojnë një raport me shkrim me rekomandime, sipas rastit, në çdo mbledhje vjetore të KGJK-së.

2. Anëtarët e komisioneve të KGJK-së propozohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe emërohen nga Këshilli Ekzekutiv. Kryetari i komisionit zgjidhet nga vetë anëtarët e komisionit. Në komision bëjnë pjesë gjyqtarë dhe persona të tjerë me njohuri dhe përvojë të spikatur në fushën që mbulon veprimtaria e komisionit. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe shpërblimit të personave të tjerë që marrin pjesë në komision përcaktohen në Rregulloren e KGJK-së.

3. KGJK-ja krijon këto komisione të përhershme:

a) komisionin e buxhetit, i cili udhëzon dhe ndihmon Zyrën e Buxhetit për përcaktimin e nevojave të gjykatave dhe enteve të tjera që lidhen me gjykatat. Anëtarët e bordit të Zyrës së Buxhetit janë anëtarë për shkak të detyrës të komisionit të buxhetit;

b) komisionin për përmirësimin e vazhdueshëm profesional, i cili shqyrton e rekomandon programe të reja, si dhe ndryshimet në programet ekzistuese për përmirësimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe të punonjësve të tjerë të gjykatave. Komisioni mban lidhje dhe koordinon me Shkollën e Magjistraturës dhe asistohet prej saj;

c) komisionin e etikës, i cili mban lidhje, koordinon, si dhe i jep mendime këshillimore Inspektoratit të KLD-së. Komisioni këshillon dhe rekomandon, kur paraqitet nevoja, ndryshime në Kodin e Etikës. Komisioni mund të japë mendime këshilluese nëse një veprimtari ndalohej ose jo nga Kodi i Etikës;

ç) komisionin për marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare, i cili ndihmon për hartimin dhe kalimin e legjislacionit që ndikon në veprimtarinë e gjykatave, si dhe mban lidhje dhe koordinon me Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Komisioni informohet për programet dhe rekomandimet e institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare për sa ato ndikojnë në gjykatat e Shqipërisë, si dhe këshillon në lidhje me to KGJK-në dhe Këshillin e saj Ekzekutiv;

d) komisionin për marrëdhëniet me mediat, organizatat jofitimprurëse dhe publikun, i cili promovon arritjet e gjyqësorit si shërbim publik dhe ndikon në rritjen e besimit të publikut te drejtësia. Komisioni siguron që veprimtaria e gjykatave të pasqyrohet në mënyrën e duhur në media, në këto organizata dhe në publik, si dhe mban lidhje me to.

4. Sipas nevojave, KGJK-ja mund të krijojë edhe komisione të tjera, të përhershme ose ad hoc.

Neni 10

Dispozitë kalimtare

Ky ligj nuk sjell efekte mbi anëtarët ekzistues të KLD-së.

Neni 11

Miratimi i Rregullores së KGJK-së

Në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji, KGJK-ja miraton Rregulloren e saj.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4604, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9400, datë 12.5.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8391, DATË 28.10.1998 “PËR SHËRBIMIN
INFORMATIV KOMBËTAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e deputetit Fatos Beja,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 10, paragrafi i tretë, fjalja “Punonjësit e SHIK-ut gëzojnë statusin e ushtarakut” zëvendësohet me fjalinë “Punonjësit e SHISH-it gëzojnë statusin e tyre”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4605, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**LIGJ
Nr.9407, datë 19.5.2005**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7843, DATË 13.7.1994 "PËR
REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME"**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Emërtimi i Kreut II ndryshohet si më poshtë:

**"KREU II
ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME".**

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është institucion buxhetor në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ushtron veprimtarinë e vet në mbështetje të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që përmbajnë rregulla për veprimtarinë e saj."

Neni 3

Pas nenit 2 shtohen nenet 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 2/1

Objekti i veprimtarisë së Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka për objekt të veprimtarisë përgatitjen, mbajtjen dhe administrimin e regjistrave të pasurive të paluajtshme dhe të dokumentacionit që lidhet me to, si dhe ushtrimin e shërbimeve për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe të veprimeve juridike, që kryhen mbi këto pasuri.

Neni 2/2

Organizimi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përbëhet nga zyra qendrore dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këto zyra janë persona juridikë publikë.

Struktura organizative dhe limiti organik i punonjësve të kësaj Zyre caktohen nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Drejtësisë."

Neni 4

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme drejton, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme drejtohet nga Kryeregjistruesi, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë."

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme

Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e zonës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme organizohet dhe drejtohet nga regjistruesi, që emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Kryeregjistruesit.

Në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mbahen:

a) regjistra të pasurive të paluajtshme;

b) harta treguese të regjistrimit për zonën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

c) vendime gjyqësore, akte administrative, kontrata, akte e dokumente të tjera, të hartuara sipas ligjit, që kanë ndikim juridik mbi pasurinë e paluajtshme apo që, sipas ligjit, duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme;

ç) plane rievuesë të paluajtshme, indekse të regjistrimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme, si dhe regjistrime të tjera, të nevojshme për veprimtarinë e zyrave vendore të pasurive të paluajtshme.

Cilido, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë të marrë të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që janë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në kartela, në harta treguese të regjistrimit, në dokumentacione të depozituara me kërkesën për regjistrim dhe në dokumentacionin që mbahet dhe administrohet nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme."

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4614, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9408, datë 19.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8701, DATË 1.12.2000 "PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë, paragrafi i dytë, paragrafi i katërt dhe paragrafi i pestë të pikës 1 të nenit 3 shfuqizohen.

Neni 2

Neni 10 "Ndarja e të ardhurave" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10

Detyrimet tatimore

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3. Veprimtaritë e lojërave të fatit, që tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Detyrimet tatimore janë:

a) Për lojërat aritmetike:

i) organizatori i lojës bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit, me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht 250 000 lekë për rrethet e kategorisë së parë, 200 000 lekë për rrethet e kategorisë së dytë dhe 150 000 lekë për rrethet e kategorisë së tretë;

ii) organizatori i lojës bingo, që nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave, paguan tatim për lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave.

Organizatori, për çdo lojë, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë;

b) për lojërat e fatit, sportive:

i) organizatori i konkurseve të parashikimeve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Organizatori, për çdo konkurs, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë;

ii) organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit me kuotë fikse, si më poshtë:

-500 000 lekë çdo muaj për shoqërinë;

- 20 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së parë;

- 15 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së dytë;

- 10 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së tretë.

Ministritë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për zhvillimin e sporteve, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara sipas shkronjës "b" të pikës 4 të këtij neni;

c) për lojërat elektronike me fitim në çast:

Organizatori i lojërave elektronike me fitim në çast paguan një tatim mbi lojërat e fatit, me kuotë fikse, çdo muaj, si më poshtë:

i) për rrethet e kategorisë së parë, 15 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 20 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

ii) për rrethet e kategorisë së dytë, 10 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 15 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

iii) për rrethet e kategorisë së tretë, 7 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 10 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike.

Në çdo rast, organizatori, për çdo lojë, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë;

ç) për lojërat e fatit të kategorisë lotari:

Organizatori i lojës lotari e çastit dhe lotari, për të cilën hidhet short, paguan tatim për lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Për çdo lotari, organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë. Për rastet kur shuma në dispozicion të lojtarëve nuk u shpërndahet fituesve, ajo mbartet në lotarinë pasardhëse, si shumë në dispozicion të lojtarëve.

5. Për efekt të dispozitave të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 4 të këtij neni, në rrethet e kategorisë së parë përfshihen Tirana dhe Durrësi, në rrethet e kategorisë së dytë përfshihen Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati, Lezha dhe Kavaja, ndërsa në rrethet e kategorisë së tretë përfshihen të gjitha rrethet e tjera.

6. Detyrimet tatimore për lojërat e fatit, në përqindje apo në shumë fikse, të paguhet në degën e tatim-taksave, ku është e regjistruar shoqëria (organizatori) jo më vonë se data 10 e çdo muaji për veprimtarinë e realizuar në muajin pararendës."

Neni 3

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22

Detyrimi tatimor për kazinotë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e

ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3. Veprimtaritë e kazinove, që taten sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në kazino, paguajnë detyrimet tatimore si më poshtë:

- a) për çdo tavolinë të lojës së fatit ruletë, një taksë mujore në masën 200 000 lekë;
- b) për çdo tavolinë të lojërave me letra dhe me zarë, një taksë mujore në masën 150 000 lekë;
- c) për lojërat elektronike dhe slotmakinat me fitim në çast, të vendosura në mjediset e kazinotë, një taksë mujore në masën 15 000 lekë për çdo kompjuter elektronik e makinë elektronike;
- ç) për makinat elektronike me më shumë se një pozicion 20 000 lekë për çdo pozicion;
- d) bashkisë, ku ushtron veprimtarinë kazinoja, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b", "c" e "ç" të pikës 4 të këtij neni."

Neni 4

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Detyrimi tatimor për hipodromet

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3. Veprimtaritë e hipodromeve, që taten sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në hipodrome, paguajnë detyrimet tatimore si më poshtë:

- a) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 1 000 000 lekësh për shoqërinë;
- b) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 20 000 lekësh për çdo pikë të vënies së basteve;
- c) për lojërat elektronike me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 20 000 lekësh për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike apo çdo pozicion loje të makinës elektronike;
- ç) bashkisë, ku ushtron veprimtarinë hipodromi, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 4 të këtij neni."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4606, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 9414, datë 20. 5. 2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8136, DATË 31.7.1996 "PËR
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Shkolla e Magjistraturës siguron formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë, prokurorë).

Formimi profesional përfshin programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me ligjin ose me kërkesë të institucioneve të interesuara, në varësi të kapaciteteve të lira, që i krijohen nga veprimtaria për formimin fillestar dhe atë vazhdues të magjistratëve, si dhe të fondeve përkatëse, që i vihen në dispozicion nga institucionet përgjegjëse apo donatorët, realizon edhe veprimtari të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore, si dhe të profesioneve të tjera juridike, që lidhen me sistemin e drejtësisë. ".

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Shkolla e Magjistraturës ka buxhetin e vet zë të veçantë në Buxhetin e Shtetit.

Për ushtrimin e veprimtarive dhe në funksion të misionit të saj, Shkolla e Magjistraturës ka të drejtë të përfitojë e të përdorë të ardhura të tjera, të realizuara nga:

- a) financime ose dhurime, të siguruara sipas ligjit, nga institucione apo persona juridikë a fizikë, vendas apo të huaj;
- b) shitja e botimeve dhe e publikimeve të saj;
- c) pagesa të të tretëve për veprimtari formimi, të organizuara nga ajo, apo shërbime të tjera profesionale, të ofruara prej saj;
- ç) pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme që ka në administrim;
- d) burime të tjera të ligjshme. ".

Neni 3

Në nenin 4 shkronja "b", fjalët "bursat e kandidatëve" zëvendësohen me fjalët "shpërblimet e kandidatëve për magjistratë".

Neni 4

Në nenin 5 shkronjat "a" dhe "d" ndryshohen si më poshtë:

- "a) Këshilli Drejtues;
- d) komisioni disiplinor. "

Neni 5

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka këtë përbërje:

- a) Kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Kryetarit të Këshillit Drejtues;
- b) Prokurori i Përgjithshëm, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues;
- c) Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- ç) dy gjyqtarë dhe dy prokurorë me përvojë, që caktohen përkatësisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nga Prokurori i Përgjithshëm;
- d) dy përfaqësues të caktuar nga Ministri i Drejtësisë;
- dh) Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- e) Dekani i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës;
- ë) Drejtori i Shkollës së Magjistraturës;
- f) përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues;
- g) dy studentë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Asambleja e kandidatëve për magistratë që ndjekin formimin fillestar.

Anëtarët e Këshillit Drejtues, sipas shkronjave "ç" dhe "d" qëndrojnë në këtë detyrë për një afat katërvjeçar, përveç rasteve kur ata japin dorëheqjen, nuk ushtrojnë më funksionin apo detyrën, që motivon caktimin e tyre si anëtarë të Këshillit, ose lirohen nga kjo detyrë me vendim të organit që i ka caktuar. "

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Këshilli Drejtues ka këto detyra:

- a) ndjek zbatimin e kriterëve për pranimin e kandidatëve, që do të ndjekin programin e formimit fillestar dhe shpall listën përfundimtare të tyre;
- b) vendos kriteret dhe rregullat e përzgjedhjes së trupës mësimdhënëse, si dhe bën emërimin dhe largimin e tyre nga detyra, me propozimin e Drejtorit të Shkollës;
- c) përcakton brenda buxhetit strukturën organizative dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ;
- ç) miraton dhe ndjek zbatimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës dhe të programit vjetor të veprimtarive të saj;
- d) përcakton, me propozimin e Drejtorit, planin mësimor, rregullon raportet ndërmjet lëndëve për përgatitjen e përbashkët dhe të veçantë të kandidatëve, sipas profileve, gjyqtarë dhe prokurorë;
- dh) propozon projektbuxhetin dhe shqyrton raportet e Drejtorit për realizimin e buxhetit dhe shpenzimet e të ardhurave;
- e) paraqet raporte vjetore përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, për rezultatet e arritura dhe drejtimet e punës për të ardhmen. "

3. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

" 3. Këshilli Drejtues mbledhet së paku një herë në tre muaj. Koha, vendi dhe çështjet e rendit të ditës së mbledhjes caktohen nga Kryetari. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës e kanë edhe jo më pak se tre anëtarë të Këshillit ose Drejtori i Shkollës. Këshilli mbledhet jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e kërkesës me shkrim. "

4. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 7 të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Drejtori i Shkollës së Magjistraturës emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Këshillit Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve dhe të prokurorëve me vjetërsi pune jo më pak se 10 vjet ose nga radhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar profesionin e juristit jo më pak se 15 vjet.

Emërimi bëhet për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë riemërimi edhe vetëm për një mandat tjetër 4-vjeçar. "

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Drejtori i Shkollës së Magjistraturës mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, ose për pamjaftueshmëri profesionale. "

3. Në paragrafin e tretë, pikat 2 e 7 ndryshohen si më poshtë:

"2. Harton dhe propozon projektin e Rregullores së Brendshme të Shkollës, projektprogramin vjetor të veprimtarive të saj, si dhe ndryshimin e tyre.

7. Propozon emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të personelit mësimdhënës, si dhe emëron dhe largon punonjësit e personelit administrativ të Shkollës. "

4. Paragrafi i parafundit dhe ai i fundit ndryshohen si më poshtë:

"Veprimtaria financiaro-administrative e institucionit realizohet nga Kancelari i Shkollës, nën autoritetin e Drejtorit. Emërimi, shkarkimi dhe përshkrimi i punës bëhen nga Këshilli Drejtues.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të personelit administrativ rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. "

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

1. Në funksionet e Drejtorit dhe të pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës mund të pranohen dhe shërbejnë edhe gjyqtarët dhe prokurorët.

2. Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhen pa konkurrim, pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës dhe propozimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

3. Periudha e ushtrimit të funksioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar a prokuror, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë.

4. Gjyqtarët a prokurorët, që shërbejnë në funksionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.

5. Drejtori i Shkollës, për efekt të pagës, barazohet me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë; pedagogët e brendshëm barazohen me gjyqtarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës; Kancelari barazohet me Kancelarin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. "

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

1. Këshilli pedagogjik kryesohet nga Drejtori i Shkollës dhe ka në përbërje:

a) personelin mësimdhënës të brendshëm dhe titullarët e lëndëve kryesore, me karakter formues e profesional, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;

b) një gjyqtar dhe një prokuror, të caktuar nga Këshilli Drejtues ndërmjet anëtarëve të këtij

Këshilli.

2. Detyrat dhe rregullat për funksionimin e këshillit pedagogjik caktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. "

Neni 9

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Komisioni disiplinor kryesohet nga Drejtori i Shkollës dhe ka në përbërje:

a) një gjyqtar dhe një prokuror, të caktuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës, që nuk janë anëtarë të këshillit pedagogjik;

b) dy pedagogë efektivë të shkollës, të caktuar nga këshilli pedagogjik;

c) dy prej kandidatëve për magjistratë, të zgjedhur çdo vit, me votim të fshehtë, nga Asambleja e kandidatëve për magjistratë. "

2. Paragrafi i fundit i pikës 2 riformulohet si më poshtë:

"Mbledhjet e komisionit disiplinor zhvillohen kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve.

Neni 10

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

1. Shkeljet disiplinore, që mund të kryhen nga kandidatët për magjistratë, përcaktohen në rregulloren e shkollës. Masat disiplinore, që jepen për këto shkelje, janë:

a) vërejtje;

b) vërejtje me shkrim;

c) vërejtje me paralajmërim;

ç) transferim nga vendi i stazhit;

d) ulje në pagë deri në masën 30 për qind, për një periudhë nga 3 deri në 6 muaj;

dh) përjashtim nga shkolla.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" jepen nga Drejtori i Shkollës, kurse ato të parashikuara në shkronjat "ç", "d" dhe "dh" jepen nga komisioni disiplinor, me propozimin e Drejtorit të Shkollës ose të jo më pak se 3 prej anëtarëve të komisionit disiplinor.

3. Asnjë masë disiplinore nuk mund të jepet pa u dëgjuar më parë personi që procedohet.

4. Masat disiplinore, të dhëna nga Drejtori i Shkollës, mund të ankimohen në komisionin disiplinor, kurse ato të dhëna nga ky i fundit mund të ankimohen në Gjykatën e Apelit të Tiranës brenda 10 ditëve nga data e komunikimit. Ankimi i bërë nuk e pezullon zbatimin e masës disiplinore për vitin e parë dhe të dytë.

5. Masa disiplinore nuk mund të jepet kur ka kaluar 1 vit nga kryerja e shkeljes.

6. Masat disiplinore, të dhëna sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, shlyhen pas një viti nga data e dhënies së tyre.

7. Rregullat e hollësishme për procedimin disiplinor caktohen nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

8. Procedurat dhe vendimet e marra për procedimin disiplinor të kandidatëve për magjistratë pasqyrohen në dosjen e tyre personale. "

Neni 11

Në nenin 13 paragrafi i parë, fjalët "më 1 tetor" zëvendësohen me fjalët "të hënën e parë të muajit tetor".

Neni 12

Në nenin 14 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:
"b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë. ".

Neni 13

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, fjala "i përhershëm" zëvendësohet me fjalën "i brendshëm".
2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Për pranimin e kandidatëve veprohet në këtë mënyrë:

Drejtori i Shkollës, në përputhje me numrin e vendeve vakante, të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kandidatët për gjyqtarë dhe nga Prokurori i Përgjithshëm për kandidatët për prokurorë, shpall njoftimin për paraqitjen e kërkesave të kandidatëve, duke bërë të njohur dokumentet që duhet të shoqërojnë këtë kërkesë, datën e mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre dhe listën e lëndëve, që do të shërbejnë si bazë për testimin e kandidatëve. ".

Neni 15

Në nenin 17 paragrafi i parë hiqen fjalët "me gojë".

Neni 16

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. ".

Neni 17

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 19/ 1

Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë:

- a) shkëlqyeshëm;
- b) shumë mirë;
- c) mirë;
- ç) mjaftueshëm;
- d) pamjaftueshëm.

Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. ".

Neni 18

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.

Me kërkesë të Drejtorit të Shkollës, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku zhvillohet stazhi, caktojnë gjyqtarë ose prokurorë, të cilët, pasi kontrollojnë punën e stazhierit, paraqesin raporte vlerësimi për të.

Drejtoria e shkollës i dërgon Presidentit të Republikës të dhënat e procesit të vlerësimit për të bërë emërimin përfundimtar të tyre në vendet vakante, në përputhje me shkallën e vlerësimit të tyre nga shkolla, pas propozimeve të bëra, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjyqtarët dhe nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët.

Kur këto vende mungojnë, ata që janë në pritje të emërimit përfitojnë pagën dhe të drejtat e tjera, përkatësisht, të gjyqtarit ose të prokurorit.

Kandidati për gjyqtar ose prokuror, në mungesë të vendeve të lira, me pëlqimin e tij, mund të punojë në administratën gjyqësore, në atë të prokurorisë, në Ministrinë e Drejtësisë ose si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë deri në hapjen e vendit për gjyqtar ose prokuror. ".

Neni 19

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22

Magjistratët e emëruar që, pa shkaqe të përligjura, nuk paraqiten në detyrë, heqin dorë apo kërkojnë largimin nga detyra, pa kaluar 5 vjet nga emërimi i tyre, detyrohen t'i kthejnë Shkollës së Magjistraturës shpërblimin që kanë marrë gjatë periudhës së parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 14 të këtij ligji, në proporcion me kohën e mospërmbyshjes së detyrimit.

Kthimi i shpërblimit, sipas paragrafit të dytë të nenit 18 dhe paragrafit të parë të këtij neni, bëhet me urdhër të Drejtorit të Shkollës, që përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përbarimit. ".

Neni 20

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues.

Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Programi i formimit vazhdues hartohet nga Drejtori i Shkollës pasi të jetë marrë, paraprakisht, mendimi i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit Pedagogjik të Shkollës. Programi i formimit vazhdues miratohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

Pjesëmarrja në këto trajnime është e detyrueshme.

Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në këto veprimtari mbulohen me fonde buxhetore, të parashikuara për këtë qëllim, përkatësisht nga fondet e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, të

Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga burime të tjera të ligjshme, të paracaktuara për këto veprimtari. "

Neni 21

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24

Propozimet për pjesëmarrjen e secilit gjyqtar dhe prokuror në veprimtaritë konkrete të formimit vazhdues i bëhen Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, përkatësisht, nga kryetari i gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës së apelit dhe nga drejtuesi i prokurorive pranë këtyre gjykatave.

Me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjyqtarët dhe Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët, miratojnë listat me emrat e personave, që do të marrin pjesë në trajnimin vazhdues, për një periudhë të paktën 1-vjeçare, sipas veprimtarive përkatëse, të përcaktuara në programin e formimit vazhdues."

Neni 22

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Gjyqtarët dhe prokurorët, që marrin pjesë në formimin vazhdues, pajisen me certifikatë, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. "

Neni 23

Në të gjitha nenet e këtij ligji fjalët "Gjykata e Kasacionit" zëvendësohen me fjalët "Gjykata e Lartë". Fjalët "bordi" ose "bordi i drejtimit" zëvendësohen me fjalët "Këshilli Drejtues", ndërsa fjalët "këshilli disiplinor" zëvendësohen me fjalët "komisioni disiplinor".

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4620, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9415, datë 20.5.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8032, DATË 16.11.1995 "PËR SHËRBIMIN E TRANSFUZIONIT DHE KONTROLLIN E GJAKUT E PRODUKTEVE TË TIJ", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8032, datë 16.11.1995 "Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e të produkteve të tij", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Pas paragrafit të parë të nenit 6 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut bashkërendon punën dhe udhëheq veprimtaritë për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut në vend."

Neni 2

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

1. Importi dhe eksporti i gjakut dhe/ose i produkteve të paqëndrueshme të tij autorizohen nga Ministri i Shëndetësisë, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse, të dala në zbatim të këtij ligji, pas këshillimit me Komitetin Kombëtar të Gjakut.

2. Importi i produkteve të qëndrueshme të gjakut autorizohet nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, sipas rregullave e procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

3. Importi i derivateve të gjakut lejohet për të gjitha produktet, vetëm pasi të jetë dokumentuar negativiteti i testeve, të bëra për antigenet ose antitruptat ndaj agjentëve infektivë, të dëmshëm për shëndetin e marrësit.

4. Vendosija e produkteve të gjakut në ruajtje, në një magazinë doganore, vlerësohet importim."

Neni 3

Në nenet 5, 8, 11, 12, 16, 23, 24 e 27 fjalët "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Shëndetësisë".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4621, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9416, datë 20.5.2005

PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE TË NDËRTUARA OSE TË BLERA ME FONDE SHTETËRORE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka qëllim të përcaktojë procedurat dhe format e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde të Buxhetit të Shtetit nga Enti Kombëtar i Banësive (më poshtë EKB) deri në vitin 2005.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj, termit e përdorur kanë këto kuptime:

1. “Privatizim” është procesi i kalimit të pronësisë nga Enti Kombëtar i Banësive te familja, sipas procedurave dhe formës së parashikuar në këtë ligj.

2. “Shumë falas” është shuma në të holla, që përfiton, si kontribut i shtetit, familja e pastrehë, sipas specifikimeve në këtë ligj.

3. “Familje që kanë zënë banesat e ndërtuara nga EKB-ja” janë familjet, që nuk janë miratuar me vendim të këshillit të bashkisë ose të komunës, për t’u strehuar në banesat e ndërtuara nga EKB-ja.

4. “Familje të pastreha” janë familjet, të cilat nuk kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banësive shtetërore” dhe janë miratuar me vendim të këshillit të bashkisë ose të komunës deri më 30 maj 1998.

5. “Familje të pastreha me statusin e qiramarrësit në ish-pronat private” janë familjet, sipas pikës 4, të cilat banojnë si qiramarrëse në banesa, pronësia e të cilave u është kthyer pronarëve, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe janë miratuar me vendim të këshillit të bashkisë ose të komunës brenda datës 31 dhjetor 1997.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

a) familjet e pastreha, të strehuara në objektet e banimit, të ndërtuara ose të blera nga enti Kombëtar i Banësive;

b) familjet e pastreha, që do të strehohen në objektet e prokuruar apo të blera nga tregu, me fondet e Buxhetit të Shtetit të vitit 2005;

c) familjet, që nuk kanë statusin e të pastrehëve dhe kanë zënë banesat para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”.

Neni 4

E drejta e përfitimit

1. Familjet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 3 të këtij ligji, përfitojnë një kontribut falas nga shteti. Shuma e përfitimit falas të çdo familjeje të pastrehë, që nuk bën pjesë në kategorinë e qiramarrësit në ish-pronën private, llogaritet bazuar në moshën e familjes dhe në numrin e pjesëtarëve, sipas tabelës “A”, që i bashkëlidhet këtij ligji. Kjo shumë nuk mund të jetë më e madhe se 740 mijë lekë.

2. Diferenca ndërmjet vlerës së banesës, të llogaritur nga Enti Kombëtar i Banësive dhe shumës falas, sipas pikës 1 të këtij neni, të shlyhet nga familjet me këste pranë Entit Kombëtar të Banësive për 25 vjet, me 3 për qind interes në vit.

3. Kur vlerat e tregut të lirë të banësive janë më të ulëta se kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banësive, shuma e përfitimit falas shumëzohet me koeficientin korrigjues “k”, i cili shpreh raportin ndërmjet vlerës së apartamentit tip në tregun e lirë me koston e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banësive, të shprehura në lek/m².

4. Për efekt të llogaritjes së shumës, që duhet të shlyejë familja, sipas pikës 2 të këtij neni, të përdoret norma e strehimit 9-11 m² sipërfaqe shfrytëzimi për frymë.

5. Familjet, të cilat kanë një pjesëtar me statusin e të verbrit, të grupit të parë, përfitojnë një sipërfaqe shtesë prej 14 m², që përbën një dhomë më vete, vlera e së cilës i shtohet shumës së përfitimit falas. Sipërfaqet e tepërta paguhen në mënyrë të menjëhershme ose me këste për 5 vjet, me interes 3 për qind në vit.

Neni 5

Privatizimi i banesave ku strehohen familjet e pastreha me statusin e qiramarrësit në ish-pronë private

1. Të gjitha familjet e pastreha, sipas pikave 1 e 2 të nenit 3 të këtij ligji, që kanë statusin e qiramarrësit në ish-pronë private, por që nuk kanë lidhur ende kontrata shitblerjeje me Entin Kombëtar të Banesave, të paguajnë, në mënyrë të menjëhershme ose me këste për 5 vjet dhe interes 3 për qind në vit, tarifën e privatizimit, sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të shumëzuara me indeksin e korrigjimit të çmimeve. Norma e strehimit për këtë kategori të jetë 4-6 m² sipërfaqe shfrytëzimi për person.

2. Kur nga llogaritjet rezultojnë sipërfaqe më të mëdha banimi se ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, diferenca shlyhet nga familja me pagesë të menjëhershme ose me këste për 5 vjet, me interes 3 për qind në vit.

3. Familjeve të pastreha, me statusin e qiramarrësit në ish-pronë private, që do të trajtohen gjatë vitit 2005 në qytetet, ku kostoja e ndërtimit nga EKB-ja është më e ulët se vlera e tregut të lirë dhe kur në këto qytete nuk investohet në banesa të reja, me miratimin e vetë familjes, nëpërmjet një deklarate, t’u shlyhet vlera e përfitimit me para në dorë. Mënyra e llogaritjes së shumës falas jepet në tabelën “A” (shembulli 5), që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 6

Organi përgjegjës për miratimin e së drejtës së përfitimit falas

1. Për familjet, që kanë lidhur kontrata me EKB-në, por që nuk u është njohur e drejta e përfitimit, sipas neneve 4 e 5 të këtij ligji, këshilli i komunës ose i bashkisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë të drejtën e përfitimit falas, pas verifikimit të dokumentacionit, që vërteton se çdo anëtar i familjes:

a) nuk ka përfutuar nga ligji për tokën;

b) nuk ushtron veprimtari ekonomike dhe nuk është subjekt i taksës mbi vlerën e shtuar apo nuk zotëron kapital (para në qarkullim, tokë, mall, ndërtime etj.), me vlerë më të madhe se dyfishi i vlerës së banesës, ku është strehuar nga Enti Kombëtar i Banesave;

c) nuk ka në pronësi banesë, sipërfaqja e banimit të së cilës i korrespondon normës së strehimit prej 9 - 11 m² për frymë.

2. Enti Kombëtar i Banesave, për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur shuma e paguar nga familja plus përfitimi falas rezulton e barabartë ose më e madhe se detyrimi i familjes ndaj tij, mbyll kontratën dhe bën kalimin e pronësisë së apartamentit në favor të familjes.

Neni 7

Privatizimi i banesave të familjeve, që kanë zënë apartamente të ndërtuara nga EKB-ja

1. Familjeve, që kanë zënë forcërisht apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, t’u lidhet kontrata e shitblerjes vetëm pasi këshillat e komunave dhe të bashkive të kenë miratuar listën e familjeve përfituese nga ky ligj.

2. Privatizimi i banesave në favor të këtyre familjeve të bëhet në mbështetje të vlerës së investimit për apartamentin e zënë nga familja, të llogaritur me koston mesatare të ndërtimit në çastin e lidhjes së kontratës me Entin Kombëtar të Banesave.

3. Për zonat, ku vlerat e tregut të banesave janë më të ulëta se kostoja e ndërtimit, privatizimi i banesës bëhet në bazë të vlerës së tregut të lirë.

4. Detyrimi i familjeve, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, të shlyhet për 10 vjet, me interes 3 për qind në vit. Këtyre familjeve nuk u zbritet shuma falas, nëse nuk gëzojnë statusin e të pastrehëve, sipas

pikave 4 e 5 të nenit 2 të këtij ligji. Në rast se familja nuk pranon të lidhë kontratën me Entin Kombëtar të Banesave, sipas kushteve të këtij neni, i hiqet e drejta e përfitimit të pronësisë mbi banesën. Në këto raste i lidhet kontratë qiraje sociale.

Neni 8

Trajtimi i familjeve me të ardhura të ulëta, që nuk kanë lidhur kontratë me EKB-në

1. Objektet e banimit, ku janë sistemuar familje, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, të cilat nuk kanë lidhur ende kontrata shitblerjeje me Entin Kombëtar të Banesave, pasi nuk janë në gjendje ekonomike për të shlyer detyrimet ndaj Entit kalojnë në pronësi të organeve të qeverisjes vendore, për lidhjen e kontratës së qirasë sociale.

2. Procesi i evidentimit të këtyre rasteve dhe kalimi i pronësisë së këtyre objekteve fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 9

Trajtimi i familjeve të strehuara, që nuk shlyejnë detyrimet ndaj EKB-së

Familjeve, që kanë lidhur kontratë me Entin Kombëtar të Banesave, por nuk shlyejnë në mënyrë të rregullt detyrimet, t'u lihet një afat prej 1 viti për sistemimin e llogarive të prapambetura. Në rast se edhe pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji këto familje nuk shlyejnë në mënyrë të rregullt detyrimet mujore pranë Entit Kombëtar të Banesave, të veprohet sipas dispozitave të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 10

Përfitimi falas i banesave

Privatizimi i banesave bëhet falas, kur familjet, sipas pikave 1 e 2 të nenit 3 të këtij ligji:

- a) kanë aktmarrëveshje me organet e pushtetit vendor, për efekt të zbatimit të planeve rregulluese;
- b) kanë statusin e ish-të përndjekurit politik;
- c) njëri prej anëtarëve ka statusin e invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare.

Neni 11

Privatizimi i banesave të filluara para vitit 1992 dhe të përfunduara nga EKB-ja me fonde të Buxhetit të Shtetit

Privatizimi i banesave të filluara para vitit 1992, të cilat kanë përfunduar me investime nga Buxheti i Shtetit, kur në to janë sistemuar familje me statusin e të pastrehut, bëhet në bazë të vlerës së objektit, pasi t'i zbritet vlera e punimeve të kryera para vitit 1992. Llogaritja e shumës falas bëhet e bazuar në koeficientin "k1", i cili shpreh raportin ndërmjet detyrimit të familjes ndaj EKB-së me koston e ndërtimit nga EKB-ja të apartamentit, sipas tabelës "A" (shembulli 3), që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 12

Zbritja për pagesat e menjëhershme

1. Në të gjitha rastet, përfshi edhe ato të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, kur familja kërkon të bëjë pagesë të menjëhershme, i bëhet zbritje në masën 30 për qind të vlerës totale dhe të pjesës së mbetur pa shlyer.

2. Nuk bëhet zbritja për rastet:

- a) e pagesës së sipërfaqes shtesë, sipas pikës 4 të nenit 4 dhe pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji;
- b) e pagesës së tarifës së privatizimit, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 13

Llogaritja e shumës falas dhe e vlerës së banesës

1. Llogaritja e shumës falas, sipas tabelës “A”, bëhet mbështetur në certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.12.1992.

2. Llogaritja e vlerës së banesës nga EKB-ja, për efekt të lidhjes së kontratës, bëhet në bazë të koston mesatare të ndërtimit dhe të koeficientit “k”, sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij ligji. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe koeficienti “k” miratohen çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

3. EKB-së do t’i njihen si shlyerje detyrimi ndaj Buxhetit të Shtetit diferencat ndërmjet vlerës së investimit, sipas pikës 2 të këtij neni dhe të ardhurave nga privatizimi, që do të rezultojnë në çastin e lidhjes ose të rilidhjes së kontratave, si rezultat:

- a) i zbritjes së shumës falas;
- b) i zbritjes së 30-përqindëshit për pagesa të menjëhershme;
- c) i kalimit të pronësisë së objektit organeve të qeverisjes vendore;
- ç) i përfitimit të banesës, sipas neneve 5 e 10 të këtij ligji.

Neni 14

Dispozita të fundit

1. Privatizimi i banesave, sipas këtij ligji, ka efekt deri më 31 dhjetor 2006. Të gjitha familjet e strehuara në objektet e banimit, sipas nenit 3 të këtij ligji, të cilat deri më 31 dhjetor 2006 rezultojnë pa kontratë me Entin Kombëtar të Banësive, në vijim do të trajtohen sipas ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë çdo vit udhëzimin për koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive dhe koeficientin “k”, sipas propozimit të Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

3. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për nxjerrjen e udhëzimit, për procedurat e blerjes së banesave në treg nga Enti Kombëtar i Banësive.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4622, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

TABELA A

Nr. i pjesëtarëve të familjes	Shuma e viteve për gjithë pjesëtarët e familjes							
	Deri 20	20-40	40-60	60-100	100-150	150-200	Mbi 200	Koefic. “k2”
	1	2	3	4	5	6	7	8
	Llogaritja e shumës falas për çdo familje (në mijë lekë)							
1	130	230	330	430	-	-	-	25
2	150	250	350	450	550	600	-	10
3	180	280	380	480	580	630	680	6
4	210	310	410	510	610	660	710	6
5	240	340	440	540	640	690	740	6
6	270	370	470	570	670	720	770	6
>6	300	400	500	600	700	750	800	6

Shembull 1 (Pika 1 e nenit 4):

Familja e pastrehë, sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.12.1992 rezulton me 4 pjesëtarë dhe me moshë totale 83 vjet.

Horizontalisht, në tabelë operohet me numrin 4 pjesëtarë, ndërsa vertikalisht i korrespondon kolona 4 me kufij moshe 60-100 vjet. Për të gjetur shumën e përfitimit për moshën totale 83 vjet, bëhet interpolimi linear:

$$\text{Shuma reale e përfitimit (ShRP)} = 410\,000 + (83 - 60) \times \frac{(510 - 410)}{(100 - 60)}$$

$$\text{ShRP} = 410\,000 + 23 \times 5 = 467\,500 \text{ lekë.}$$

Shembulli 2 (Pika 1 e nenit 4):

Familja e pastrehë përbëhet nga 5 pjesëtarë me moshë totale 220 vjet.

Referuar shembullit 1, për të gjetur shumën reale të përfitimit për moshën 20 vjet (diferenca 220 – 200), zbatohet koeficienti $k_2 = 6\,000$ lekë (rreshti 5, kolona 8) dhe shtesa do të jetë:

$$20 \times 6\,000 = 120\,000 \text{ lekë}$$

ShRP duhet të plotësojë kushtin $690\,000 + 120\,000 \leq 740\,000$ lekë, ku në këtë rast kjo është shuma maksimale e përfitimit.

Shembull 3 (pika 3 e nenit 4):

Banesa ndodhet në qendër të banuar ku vlera e apartamentit është më vogël se kosto e ndërtimit nga EKB-ja. Në këtë rast përdoret koeficienti korrigjues:

Vlera e apartamentit tip në tregun e lirë

$$K = \text{-----}$$

Kostoja e ndërtimit nga EKB-ja

Ky koeficient shumëzon shumën e përfitimit të llogaritur sipas shembujve 1 e 2.

Shembull 4 (neni 11):

Banesa ka punime të kryera para vitit 1992.

- Shuma e përfitimit të familjes sipas shembullit 1 është 467 500 lekë.
- Kostoja e plotë e ndërtimit nga EKB-ja është 1 200 000 lekë (përfshirë edhe punimet para vitit 1992).

- Vlera e punimeve të falura (punimet para vitit 1992) është 800 000 lekë.

- Vlera e koeficientit korrigjues “ k_1 ” është:

Detyrimi i qytetarit ndaj EKB-së

$$K_1 = \text{-----}$$

Kostoja e ndërtimit nga EKB-ja

Ku, detyrimi i qytetarit ndaj EKB-së është diferenca ndërmjet kostos së plotë dhe punimeve të falura, pra:

$$1\,200\,000 - 800\,000 = 400\,000 \text{ lekë}$$

$$400\,000$$

$$K_1 = \text{-----} = 0,33$$

$$1\,200\,000$$

$$\text{ShRP} = 0,33 \times 467\,500 = 155\,000 \text{ lekë}$$

Shembull 5 (pika 3 nenit 5):

Llogaritja e shumës së përfitimit falas për familjet qiramarrëse në ish-pronë private, në rastin kur vlerat e tregut të lirë të banesave janë më të larta se kostoja e ndërtimit nga EKB-ja, por në atë njësi vendore nuk investohet në banesa të reja

$$\text{ShRP} = (S \times K) - (T_p \times I) - \text{ShO};$$

Ku:

S – është sipërfaqja mesatare e shfrytëzimit të apartamentit që përfiton familja;

K – është kostoja e ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi nga EKB-ja;
 Tp – është tarifa e privatizimit;
 I – është indeksi i ndryshimit të çmimeve në raport me mesataren e vitit 1993;
 ShO – janë shpenzimet operacionale të Entit Kombëtar të Banesave.

Struktura e apartamentit	Sipërfaqja në m2 (S)	Tarifa e privatizimit në lekë (Tp)
1+1	43,1	20 000
2+1	57,4	30 000
3+1	66,1	40 000

LIGJ
Nr.9417, datë 20.5.2005

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.8894, DATË 14.5.2002 “PËR AGJENCINË E
 TRAJTIMIT TË KREDIVE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
 I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Agjencia pagan taksën për veprimet që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor në fund të ekzekutimit dhe në raport me shumën e ekzekutuar.

Agjencia përjashtohet nga taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.”.

Neni 2

Në nenin 7, pas fjalëve “ose nuk janë të kontrolluara nga shteti”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Agjencia ka të drejtën e kalimit kapital të aseteve të veta, sipas dispozitave ligjore në fuqi.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4607, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
 1639

Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdolloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 14.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë